



## REPUBLIKA E SHQIPERISE

**MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE  
DHE ADMINISTRIMIT TE UJERAVE**  
Nr. 6235 Prot. Tirane, me 27.11.2007

**MINISTRIA E SHENDETESISE**  
Nr. 4492 Prot. Tirane, me 4.12.2007

### UDHEZIM

(Nr.8, date 27.11.2007)

### PER

### NIVELET KUFI TE ZHURMAVE NE MJEDISE TE CAKTUARA

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe në zbatim të pikës 2, të nenit 2 të Ligjit nr.9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”,

### U D H E Z O J M E:

1. Nivelet kufi të zhurmës për mjedis të caktuar, të jenë sipas Vlerave Udhezuese të Organizatës Botërore të Shëndetsisë (OBSH) të dhëna më poshtë në Aneksin 1, bashkëngjitur këtij udhëzimi.
2. **Si** mjedis të caktuar, për efekt të zbatimit të këtij udhëzimi, janë identifikuar mjediset e zonave të banimit, (jashtë banesës, mjediset e brendshme të banesës), institucionet (arsimore, parashkollore e shëndetësore), zona me aktivitet social-ekonomik, mjedisë urbane dhe parqet publike.
3. Ekspertët e certifikuar që bëjnë matjet e zhurmës në mjediset e përmendura në pikën 2 të këtij udhëzimi, mbajnë parasysh spjegimet që shoqërojnë Aneksin 1.
4. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Ministria e Shëndetsisë dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

Ky udhëzim hyn në huqë pas botimit në Fletoren Zyrtare

**Ministri i Mjedisit, Pyjeve  
dhe Administrimit të Ujërave**

**Ministri i Shëndetsisë**

**Lufter XHUVELI**

**Nard NDOKA**

## ANEKSI 1

### NIVELET KUFIT TE ZHURMES PER MJEDISE TE CAKTUARA

Mjedisi	Efekti kritik ne shendet	LA <sub>eq</sub> (dBA)	Koha baze (ore)	LAm <sub>ax</sub> Fast (dB)
<b>Zona banimi</b>				
Jashte banese	Bezdi (shqetesim) serioze gjate dites dhe mbremjes	55	16	-
	Bezdi (shqetesim) i moderuar gjate dites dhe mbremjes	50	16	-
Ne brendesi te banesave	Kuptueshmeri e bisedes dhe (bezdi) shqetesim i moderuar gjate dites dhe mbremjes	35	16	-
Ne brendesi te dhomes se fjetjes	Prishja e gjumit naten	30	8	-
Jashte dhomes se fjetjes	Prishje e gjumit, dritare e hapur (vlera nga jashte)	45	8	-
<b>Institucione</b>				
Klasa mesimi, institucione-mjedise parashkollore (brenda)	Kuptueshmeri e bisedes, veshtiresi ne kuptimin e informacionit, komunikimin e mesazhit	35	Gjate mesimit	-
Dhomat e fjetjes ne kopshte (brenda)	Prishje e gjumit	30	Koha e gjumit	-
Oborri i shkolles, vendet e lojrave ne shkolle	Bezdi (shqetesim) - (burime te jashteme)	55	Koha e pushimit	-
Spitale, salla, dhoma (brenda)	Prishja e gjumit naten Prishja e gjumit dite dhe ne mbremje	30	8	40
		30	16	
Spitale, salla trajtimi (brenda)	Ndikim ne pushim, clodhje	# 1		
<b>Zona me aktivitetet social-ekonomik</b>				
Zona industriale, tregtare, qarkullimi trafiku (mjedis i jashtem dhe i brendshem)	Dentim degjimi	70	24	110
<b>Mjedis urban</b>				
Mjedise publike, te jashtme apo te brendshme	Dentim degjimi	85	1	110
Ceremoni, festivale dhe argetime	Dentim degjimi (klientet < 5 here/ vit)	100	4	110
Muzike nepermjet kufjeve te degjimit	Dentim degjimi	85 # 4	1	110
Tinguj – zhurme impulsive nga fishekzjarret dhe armet e zjarrit	Dentim degjimi (te rriturit)	-	-	140#2
	Dentim degjimit (femijet)			120#2
<b>Parqe publike</b>				
Parqet natyrore dhe zonat e mbrojtura	Prishje e qetesise	#3		

#### Spjegime:

LA<sub>eq</sub> (dBA) = Niveli ekuivalent i matur ne shkallen A

Koha baze (ore) = Koha gjate se ciles behet matja

LAm<sub>ax</sub> Fast (dB) = Niveli i matur ne shkallen A ne menyren Fast (e shpejte)

**# 1 = Sa me e ulet qe te jete e mundur.**

**# 2 = Presioni zanor maksimal ( $L_{Amax}$ , fast) matur 100 mm larg veshit.**

**# 3 = Zonat e jashteme te qeta duhet te mbrohen dhe raporti i zhurmes hyrese/shtese me zhurmen e fonit natyral duhet te ruhet sa me i ulet qe te jete e mundur.**

**# 4 = Nen kufjet e degjimit, pershtatur me vlerat fushes se lire.**